

Marrëveshje për mbrojtjen e të dhënave personale

Në mënyrë që të llogariten *Benefits* (përfitimet) sipas Benefit Program, myWorld Albania Sh.p.k., një shoqëri e regjistruar në Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Kulla nr. 2, Kati i 5^{të} - Zyra A3, 1000 Tiranë, Shqipëri mbledh dhe përpunon të dhënat personale të Anëtarit, veçanërisht emrin dhe mbiemrin e tij, titullin, gjininë, datën e lindjes, adresën e postës elektronike/email, adresën postare, koordinatat e adresës (gjatësia dhe gjerësia gjeografike), numrin-at i/e telefonit, numrin-at i/e faksit, ID-në e Anëtarit, detajet e llogarisë bankare (banka, IBAN, SWIFT dhe emrin e përfituesit të llogarisë bankare) si dhe informacionet rreth aktiviteteve të blerjeve nga ana e Anëtarëve (data, vendndodhja dhe koha e blerjes, shuma e blerjes, valuta, informacioni i shportës së blerjes, sektori, lloji i blerjes (*online, offline*, tek kompanitë e vogla dhe të mesme (SME), ose tek *Key Account partnerët* përmes myWorld Card). Si përpunues i të dhënave të sipërpërmendura, myWorld Albania Sh.p.k., një shoqëri e regjistruar në Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Kulla nr. 2, Kati i 5^{të} - Zyra A3, 1000 Tiranë, Shqipëri mund të përdorë gjithashtu si përpunues të të dhënave myWorld 360 AG (Grazbachgasse 87-93, 8010 Graz, Austri).

Anëtari nëpërmjet këtij akti jep pëlqimin e tij – nga i cili mund të heqë dorë në çdo kohë - që myWorld Albania Sh.p.k., një shoqëri e regjistruar në Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Kulla nr. 2, Kati i 5^{të} - Zyra A3, 1000 Tiranë, Shqipëri mund të përpunojë detajet e të dhënave të tjera personale të përmendura më sipër për qëllimin të kontaktimit me të përmes postës ose personalisht nga myWorld Albania Shpk, një shoqëri e regjistruar në Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Kulla nr. 2, Kati i 5^{të} - Zyra A3, 1000 Tiranë, Shqipëri me telefon ose me anë të njoftimit elektronik ("*push notification*") për t'i bërë reklamë për *Benefit Program* ose për oferta të myWorld dhe Kompanive Partnere.

Në mënyrë që të informohet në lidhje me Kompanitë e reja Partnere, mundësitë e reja të blerjes ose ofertat speciale, Anëtari gjithashtu nëpërmjet këtij akti jep pëlqimin e tij - nga i cili mund të heqë dorë në çdo kohë – që Rekomanduesit të Anëtarit ti ofrohen dhe shfaqen informacionet si në vijim: ID-ja e Anëtarit, emri dhe mbiemri, adresa e email-it dhe numri i telefonit..

Anëtari mund të tërheqë pëlqimin(et) e tij (edhe veçmas) me shkrim nga World Albania Sh.p.k., një shoqëri e regjistruar në Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Kulla nr. 2, Kati i 5^{të} - Zyra A3, 1000 Tiranë, Shqipëri ose me email nëpërmjet service.al@myworld.com në çdo kohë me efekt të menjëhershëm. Pëlqimi i dhënë në këtë akt për përpunimin e të dhënave personale është i vlefshëm deri kur Anëtari ka tërhequr këtë pëlqim. Nëpërmjet këtyre të dhënave të kontaktit, Anëtari gjithashtu mund të kërkojë të drejtën e tij për të marrë informacione, për të kryer ndryshime, fshirje, kufizime në lidhje me përpunimin e të dhënave dhe transparancën e tyre.